

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rrustem Begolli, me zyrtaren ligjore Sanije Troshupa, në çështjen penale kundër të pandehurit I.S., nga P., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1435/2018, të dt: 27.07.2018, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP.II.nr.1435/2018, të dt: 27.07.2018, më **20.09.2018**, jashtë seancës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i PP.II.nr.1435/2018, të dt: 27.07.2018, dhe gjykata nxjerr këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

I.S.: nga i ati H., e ëma P., e gjinsë S., i lindur me datë ..., me vendbanim në fshatin Ll., Rr."V.", Komuna G., me numër personal ..., serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e: Me datë 21.03.2018, rreth orës 12:30 në shtëpinë familjare në fshatin Ll., Komuna e G., i pandehuri me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, ashtu që pas një mosmarrëveshje me babanë e tij – të dëmtuarin H., të njëjtit i është afruar dhe e ka goditur me kokë në pjesën e fytyrës, pjesën e buzës dhe pastaj i pandehuri e ka goditur edhe me shuplakë të hapur në fytyrë në faqen e majtë;

- **Me këtë ka kryer veprën penale, Sulmi nga neni 187 par. 1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të neneve 7, 17, 23, 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, të pandehurit I.S. i shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

I pandehuri: **I.S.** dënohet me gjobë në shumë prej **400.00 € (katër qind euro)**, të cilën dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga 1 (një) ditë burgimi për 20 (njëzet) €, të gjobës.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet procedurale për paushallin gjyqësor në shumë prej **20€**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari: **H.S.**, me vendbanim në fshatin Ll., Rr."V.", Komuna G., për realizimin e kërkesës pasuror juridike, udhëzohet në kontest të regullt civilo – juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me PP.II.nr.1435/2018, të dt: 27.07.2018, ka akuzuar I.S., se ka kryer veprën penale – Sulmi nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, dhe

njëherësh nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: kallëzimi penal i Policisë së Kosovës nr.2018 – AT - 007, të datës 15.02.2018, deklarata e të demtuarit e dhënë në procedurën paraprake, deklarata e të pandehurit e dhënë në procedurë paraprake, si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata konstaton se i pandehuri I.S., është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Sulmi nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Me rastin e shqyrtimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata u ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 74 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.3317/2018 të dt20.09.2018

Zyrtare Ligjore,
Sanije Troshupa

G j y q t a r i
Rrustem Begolli

KËSHILLA JURIDIKE:Të pandehurit ose mbrojtësit e tyre, në afat prej (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi–urdhri ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.